

XIII AVOKATI POPULLOR

NOCIONET KRYESORE :

Avokati popullor; parashtresa.

PYETJE:

- 1. Kush e zgjedh Avokatin popullor të RM-së?**
- 2. Sa zgjat mandati i Avokatit popullor?**
- 3. Si nis procedura para Avokatit popullor?**
- 4. Në cilat raste Avokati popullor i RM-së mund ta hedhë poshtë parashtresën?**
- 5. Çfarë masash mund të ndërmarrë Avokati popullor gjatë procedurës?**
- 6. Çfarë mund të bëjë Avokati popullor i RM-së në qoftë se vërteton shkelje të të drejtave të qytetarëve?**
- 7. A mund që Avokati popullor i RM-së të kryejë mbikqyrje mbi veprimtarinë e gjykatave?**
- 8. Çfarë veprimesh mund të ndërmarrë Avokati popullor i RM-së në qoftë se organi nuk vepron sipas rekomandimeve të tij.**

1. Pozita, zgjedhja dhe mandati i Avokatit popullor

Avokati popullor në Republikën e Maqedonisë (ose Ombudsman, paditësi i parlamentit, i besuari i parlamentit, mediatori, siç emërohet në të drejtën e krahasuar) është institucion i cili mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve të shkelura nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat e tjera të cilat kanë autorizime publike.

Institucioni i këtij lloji për herë të parë është aplikuar në Suedi, ndërsa sot ekziston në shumë vende të botës, që kontribuon për kufizimin dhe kontrollin më efikas mbi administratën shtetërore në interes të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Avokati popullor në Republikën e Maqedonisë është organ i pavarur, i cili në mënyrë të pavarur ushtron funksionin e tij. Megjithë se atë e zgjedh Kuvendi i RM-së të cilit Avokati popullor i raporton më së paku njëherë në vit, prapëse prapë, Avokati popullor nuk është organ i trupit legjislativ, por organ i pavarur i cili veprimatrinë në kompetencë të tij e ushtron mbi bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit.

Kuvendi e zgjedh Avokatin popullor me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve që u përkasinë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Kuvendi i RM-së e zgjedh Avokatin e popullit për një periudhë prej 8 vjetëve, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Për vendin e Avokatit popullor mund të zgjidhet personi që i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me ligjin për krijimin e marrëdhënieve të punës në organin e administratës shtetërore, juristë i diplomuar që ka përvojë pune më shumë se nëntë vjet në punët juridike dhe aktiviteti i të cilit është dëshmuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Para marrjes së detyrës, Avokati popullor jep deklaratën solemne para Kuvendit.

Funksioni i Avokatit popullor është i papajtueshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër publik a profesion ose me anëtarësimin në parti politike.

Kuvendi, gjithashtu, e shkarkon Avokatin popullor:

- në qoftë se këtë vetë e kërkon;**
- në qoftë se është dënuar për vepër penale të dënimit me burgim më së paku 6 muaj;**
- në qoftë se përgjithmonë e humb aftësinë psikofizike për ushtrimin e funksionit të Avokatit popullor, që vërtetohet mbi bazën e mendimit dhe të konstatimit të institucionit kompetent shëndetësor;**
- për shkak të ushtrimit të funksionit në mënyrë joprofesionale të anëshme dhe të papërshatshme të Avokatit popullor.**

Kuvendi i RM-së, me propozim të Avokatit popullor, i zgjedh zëvendësit e tij për një periudhë prej 8 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Kompetencat e Avokatit popullor

Ombudsmanët në të drejtën e krahasuar ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e organeve administartive, ndërsa në disa vende, si ç'janë Suedia dhe Franca, edhe mbi veprimtarinë e gjykatave. Do të thotë, Ombudsmanët paraqiten si mbrojtësit e të drejtave të cënuara nga ana e organeve administrative, kurse më rallë edhe nga ana e gjykatave.

Avokati popullor i RM-së është kompetent që t'i mbrojtë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur u cënohen nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe nga organe e organizata të tjera që kanë autorizime publike (psh. Aeroporti, Elektrodistribucioni etj). Avokati popullor ndërmer aktivite dhe masa për mbrojtjen nga zvarritjen e proceseve gjyqësore ose nga kryerja e punëve në mënyrë të papërgjegjshme nga shërbimet gjyqësore, duke mos shkelur principet e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Në pajtim me Amendamentin XI Avokati popullor i kushton kujdes të veçantë parimit të mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të anëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetadministrimit lokal dhe në shërbimet dhe institucionet publike.

Avokati popullor ngre procedurë:

- në bazë të parashtrësive të qytetarëve;
- me vetiniciativë.

Parashtrësia drejtuar Avokatit popullor, duhet të nënshkruhet dhe të përmbajë të dhëna personale të dorëzuesit të parashtrësës, të përmbajë rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat bazohet parashtrësia. Në parashtrësë duhet përmendur edhe organi, përkatësisht personi për të cilin ka të bëjë parashtrësia si dhe të përmendet nëse parashtruesi tashmë ka deponuar mjete juridike dhe cilat mjete ka depunuar. Parashtrësia për fillimin e procedurës paraqitet me shkrim dhe për të nuk paguhet taksa. Parashtrësia mund të jepet dhe me gojë në procesverbal. Në raste urgjente, Avokati popullor mund të pranojë parashtrësia edhe nëpërmjet telefonit, për të cilën mbahet shënim zyrtar. Për parashtrësën e pranuar me telefon, parashtruesi është i detyruar ta paraqesë në afat prej 10 ditëve me gojë ose me shkrim në procesverbal para Avokatit popullor.

Procedura pranë Avokatit popullor fillon me pranimin e parashtrësës. Procedura është joformale, e shpejtë dhe e besueshme. Nga momenti që do ta pranojë parashtrësën, Avokati popullor vendos nëse do ta pranojë ose jo. Avokati popullor e hedh poshtë parashtrësën në disa raste:

- në qoftë se parashtrësia është anonime, përveç rastit kur bëhet fjalë për interes të përgjithshëm;

- në qoftë se nuk është paraqitur në afatin e parashikuar ligjor, përkatësisht në qoftë se kanë kaluar më shumë se 1 vjet nga koha e veprimit ose nga dita e vendimit të organit, arganizatës ose institucionit, për veç nëse vërtetohet se iniciatori ka shkelur afatin për shkaqe të arsyeshme;
- në qoftë se me parshtresën fyhet organi ose keqpërdoret e drejta e paraqitjes së parshtresës;
- në qoftë se nga të dhënat që disponon Avokati popullor, konstaton se nuk ka të bëjë me shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të parashtruesit.
- në qoftë se parshtresa nuk është e plotë dhe në qoftë se parashtruesi, pas njoftimit paraprak nga Avokati popullor, nuk e plotëson;
- në qoftë se çështja është para organeve gjyqësore, sepse Avokati popullor nuk procedon për çështjet për të cilat vazhdon procedura gjyqësore.

Në qoftë se Avokati popullor vendos që mos të ngrejë procedurë, atëherë ai është i detyruar ta njoftojë parashtruesin brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të parashatresës.

Në qoftë se Avokati popullor ngrejë procedurë me vetiniciativë ose nëse ndonjë person tjetër i drejtohet në emër qytetarit të dëmtuar për të ngritur procedurë, është i nevojshëm pëlqimi i qytetarit të cilit i janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore.

Nëse Avokati popullor vendos të ngrejë procedurë, duhet ta njoftojë parashtruesin dhe organin, përkatësisht arganizatën për të cilën ka të bëjë parashtrësia.

Në kuadër të kompetencës së tij, gjatë procedurës, Avokati popullor mund t'i ndëmarrë veprimet:

- *të kërkojë sqarime të nevojshme, informacione, dhe prova nga organet, përkatësisht arganizatave, për përmbajtjen e parashtrësës;*
- *të hyjë në ambijentet zyrtare dhe të bëjë këqyrje direkte në veprimtarinë në kompetencë të organit, përkatësisht arganizatave;*
- *të thërrasë në bisedë funksionarë dhe nëpunës shtetërorë të organit, përkatësisht arganizatën dhe çdo person tjetër;*
- *të kërkojë mendim nga persona dhe institucione shkencore.*

Organet dhe arganizatave janë të detyruara të bashkëpunojnë me Avokatin popullor dhe t'i sigurojnë të gjitha informacionet e kërkuara prej tij, pa marrë parasysh shkallën e besueshmërisë dhe t'i mundësojnë zbatimin e procedurës. Rregullat për ruajtjen e fshehtësisë janë të detyrueshme edhe për Avokatin popullor.

Kur Avokati popullor do ta përfundojë procedurën, për këtë do ta informojë dorëzuesin e parashtrësës.

Në qoftë se Avokati popullor konstaton se janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, mund të ndërmarrë njërën nga *masat vijuese*:

- të japë porosi, propozime, mendime dhe të tregojë mënyrën e mënjanimi të shkeljes së konstatuar;
- të propozojë që ta përsërisë procedurën e caktuar në pajtim me ligjin;
- të ngre iniciativë për zbatimin e procedurës disiplinore kundër nëpunësit, përkatësisht, personit përgjegjës;
- të kërkojë nga prokurori publik kompetent ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë.

Në qoftë se Avokati popullor konstaton shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore ose konstaton padrejtësi të tjera dhe në qoftë se çmon se ekzekutimi i aktit administrativ do të shkaktojë dëm të paripërmirësueshëm për të drejtën e personit të interesuar, do të kërkojë:

- pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ deri në vendimin e organit të shkallës së dytë;
- pezullimin e ekzekutimit të aktit administrativ deri në vendimin e gjykatës kompetente;

Pra, Avokati popullor nuk ka të drejtë të ndërhyjë në mënyrë direkte në veprimtarinë e organeve të administratës ose organizatave në kuptimin që t'i ndryshojë vendimet e tyre. Ai mund vetëm t'i drejtojë kritikë organit të përshtatshëm ose të japë propozim për përmirësimin e veprimtarisë së tij, të propozojë zbatimin e procedurës disiplinore, kundravajtjen ose procedimin penal, por jo edhe të ndërmarrë masa të detyrueshme kundër të njëjtit. Do të thotë, pushteti i Avokatit popullor është më tepër moral dhe ai ndikon me forcën e autoritetit të tij e jo me mjete të detyrueshme.

Organet janë të detyruara ta njoftojnë Avokatin popullor të Republikës së Maqedonisë për masat e ndërmarra mbi bazë të propozimeve, mendimeve ose porosive të tij, më së voni në afat prej 30 ditëve.

Në qoftë se organi, përkatësisht organizata, nuk e njofton Avokatin popullor për zbatimin e propozimeve ose porosive të tij, ose propozimet dhe porosive i ka pranuar pjesërisht, Avokati popullor për këtë mund ta njoftojë drejtpërdrejt me raport të veçantë organin më të lartë, ministrinë kompetente, Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, dhe në qoftë se ato nuk ndërmarrin masa të nevojshme, e as Kuvendi e RM-së ose çështjen ta shpallë në mjetet e informimit publik me shpenzim të organit i cili ka shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore.

Në këtë mënyrë, përveç ndikimit përmes porosive dhe kritikave drejtuar në mënyrë direkte organit veprimtarinë e të cilit Avokati popullor e ka shqyrtuar, në rast të mosprocedimit nga organi në fjalë, Avokati popullor ndikimin e tij e ushtron edhe përmes njoftimeve drejtuar organeve më të larta, përkatësisht organeve të cilat e kontrollojnë veprimtarinë e tyre, si dhe përmes njoftimeve drejtuar publikut me çka ndikohet mbi mendimin e përgjithshëm i cili gjithashtu është faktor i rëndësishëm për kontrollin e pushtetit ekzekutiv.